



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
SARANDË

Nr. 00312/467 Regj. Them.

Sarandë, më 13.06.2019

SHPALLJE PUBLIKE
(Për njoftimin e të paditurit Belul Bektash Hamiti)

Njoftohet i padituri **Belul Bektash Hamiti**, me banim në Lagjen "Sinan Ballaci" Delvine, se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është regjistruar dhe po shqyrtohet çështja civile me nr. **00312/467 regj.them.**, e regjistruar në datë 26.02.2019, që i përket:

- Paditësve:** 1. Florida Barjam Hamiti dhe, 2. Silvana Shefqet Braho.
- Të paditur:** 1. **Belul Bektash Hamiti**; 2. Behare Bektash Lame; 3. Liljana Bektash Hamiti; 4. Hava Muharem Hamiti; 5. Androniqi Bektash Bajraktari; 6. Siri Bektash Hamiti; 7. ZVRPP-Sarandë.
- Person i tretë:** 1. Engiende Hasan Hamiti; 2. Zenepe Bajram Hamiti; 3. Ilia Bajram Papa; 4. Arjana Bajram Tushe; 5. Nikollaq Bajram Papa; 6. Elena Muzafer Hazbi; 7. Kostandinos Dhimitër Papa; 8. Nansia Dhimitër Papa.
- Objekti:** 1. Detyrimin e të paditurve të njohin bashkëpronare mbi 1/5 pjesë secili paditësen Silvana Hrabo (Hamiti), si dhe trashëgimtarët ligjorë të shtetasit Bajram Hamiti, paditësen Florida Hamiti, Ilia Papa, Arjana Tushe, Nikollaq Papa dhe Dhimitër Papa...mbi një shtëpi banimi dy katërshe e përbërë nga pesë dhoma, e ndodhur në qytetin e Delvinës, lagja "Sinan Ballaci", e regjistruar në ZVRPP-Sarandë, me numër pasurie 11/26, volumi 6, faqe 9.
2. Rregullimin e trashëgimisë për trashëgimtarin e Bajram Hamitit...
3. Regjistrimin e kësaj prone në bashkëpronësi sipas pjesëve takuese që u takojnë...

Në kushtet që njoftimi i të paditurit nuk është i mundur të realizohet në ndonjë mënyrë tjetër, me këtë "shpallje publike" ai njoftohet se kundër tij është ngritur padia me objektin e sipërcituar dhe se seanca pergatitore do të zhvillohet në datë **08.07.2019, ora 10:30**, në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë. Me kalimin e këtij afati njoftimi konsiderohet i kryer dhe gjykimi mund të vazhdoi në mungesë të të paditurës.

Kjo shpallje të afishohet në stendën e njoftimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në vendbanimin e të paditurës, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin e fundit të ditur e paditura.

Personi dhe/ose institucioni i ngarkuar për afishimin e kësaj shpallje, duhet të njoftojë gjykatën për datën e vendosjes në vendet përkatëse.

GJYQTAR
SOKOL PINA